



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Departamentit i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit**

Adresa: *Kontrolli i Lartë i Shtetit Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; eb-site .klsh.org.al*

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ 11.2018

**V E N D I M**

**Nr.182, Datë 3.12.2018**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT DIBËR**  
**“MBI VEPRIMATARINË EKONOMIKO FINANCIARE, MONITORIMI DHE**  
**MBROJTJA E MJEDISIT”**

*(për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datën 31.07.2018)*

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Dibër, rezultoi që veprimtaria ekonomike e financiare përputhet në përgjithësi me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator në fuqi në drejtim të planifikimit, miratimit, ndërsa veprimtaria mbi monitorimin dhe mbrojtja e mjedisit nuk ka qenë plotësisht efektive, veçanërisht në vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në dhënjen e lejeve mjedisore tipi (C), etj.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**VENDOSA**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Rregullshmërisë dhe përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Dibër, sipas programit të auditimit nr.1012/1, datë 2.09.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2015 deri në 31.07.2018.

**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** DRM Dibër në formulimin e akteve të refuzimit të lejeve të tipi (C), është konstatuar se, mungojnë citimet në nenin apo pikën e bazës ligjore e nënligjore dhe pikat shtojcës përkatëse për secilin prej kushteve të paplotësuara, duke u mjaftuar vetëm me përmendjen apo citimin e ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011“Për lejet e mjedisit”, si dhe mungojnë aktverifikimet në terren dhe relacionet përkatëse të grupit të specialistëve për argumentimin e tyre. *(Trajtuar më hollësisht në faqe xxx të Raportit të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** DRM Dibër të marrë masa, që komisionet e shqyrtimit të dosjeve për aplikim të lejeve të përgatisin dhe formulojnë aktrefuzimet në mënyrë të plotë, duke i mbështetur shkaqet e refuzimit me bazën nënligjore e kushtete sipas pikave të shtojcës përkatëse.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi.*

**2. Gjetje nga auditimi:** DRM Dibër ka të evidentuar listën e subjekteve të pajisur me leje mjedisore të tipi (C), të nxjerrë nga bashkëpunimi periodike me DRT Dibër, QKL apo dhe me NJVQV<sup>-të</sup> (4 bashki) për numrin e përgjithshëm të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në qarku Dibër e që kanë ndikim në mjedis me detyrim pajisjen me leje mjedisi për ushtrimin e veprimtarive. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 40 deri 76 të Projekt Raportit të Auditimit).*

**2.1.Rekomandimi:** DRM Dibër në bashkëpunim me AKM Tiranë të marr masa për të evidentuar e ndjekur subjektet mbajtës të lejeve mjedisore tipi (C), duke rakorduar me DRT Dibër, QKL dhe NJVQV<sup>-të</sup>, për numrin e përgjithshëm të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në qarkun Dibër.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi.*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga DRM Dibër të mbahen dhe hartohen me rregulla të plotësimit dhe drejtshkrimit procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve teknike për verifikimin dhe shqyrtimin e kërkesave për miratimin, ose refuzimin e lejeve mjedisore, pasi u konstatuan mangësi në konceptim dhe formulim, nuk janë evidentuar diskutimet, situatat, zhvillimi i tyre, si dhe nuk kanë prezantuar para Drejtorit të DRM Dibër informacion të plotë në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10448, datë 14.07.2011“Për lejet e mjedisit” dhe VKM nr. 419, datë 25.06.2014. *(Trajtuar më hollësisht në faqe xxx të Raportit të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** DRM Dibër të marr masa që të pasqyrohet në procesverbalet e mbajtura në mbledhjen e komisioneve për leje mjedisi tipi (C), informacioni i plotë për vlerësimin e dokumentacionit, duke argumentuar aktet e miratimit, apo refuzimit me arsyet dhe argumentet përkatës. Për këtë në aktmiratime të përcaktohen zotërimi i dokumentave të pronësisë, dokumentimi i mendimit të NJVQV<sup>-ve</sup> dhe informacioni tjetër që lidhet me mbrojtjen e mjedisit. Në çdo rast të citohen saktësisht dhe në mënyrë objektive arsyet e refuzimit, mangësitë ligjore dhe dispozitat përkatëse, duke kërkuar respektimin e kushteve, apo kriterëve ligjore që duhen plotësuar nga subjektet.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi.*

**4. Gjetje nga auditimi:** Në DRM Dibër u konstatua se, subjektet që paraqesin raportet e vetëmonitorimit nuk kanë saktësinë dhe besueshmërinë e analizave, pasi mungojnë laboratorët shtetërorë me ndihmën e të cilëve mund të sigurohet informacion mbi saktësinë e laboratorëve të akredituar sipas VKM nr. 1185, datë 18.11.2009“Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit në mjedis”, vendim i cili ka nevojë për ndryshime dhe përshtatje me kushtet e reja, që kanë sjellë mangësi në raportet e vetëmonitorimit. *(Trajtuar më hollësisht në faqe xxx të Raportit të Auditimit).*

**4.1.Rekomandimi:** DRM Dibër në bashkëpunim me AKM Tiranë të marrin masa që të parashikohen fondet e nevojshme për paisje laboratorike, ose të lidhin kontrata me subjekte të

licensuara dhe akredituara për marrjen e shërbimit të kërkuar për plotësimin e VNM me analiza shoqëruese.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi.*

**5. Gjetje nga auditimi:** DRM Dibër për periudhën raportuese 2015; 2016; 2017 deri në 31.07.2018, në shqyrtimin e procedurave të miratimit të lejes tipi (C) e ka miratuar pa përgjigje nga NJQV<sup>-të</sup>, duke zbatuar në heshtje sipas të drejtës që jep Kreu IV, VKM nr. 419, dat 25.06.2014, pika 2 dhe 3, ku citohet se: “... brenda 3 ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit, DRM dërgon një kopje të aplikimit në NJVQV e cila jep mendimin e saj me shkrim brenda 3(tre) ditë pune...”. (*Trajtuar më hollësisht në faqe xxx të Raportit të Auditimit*).

**5.1. Rekomandimi:** DRM Dibër të marr masa dhe gjejë forma bashkëpunimi për miratimin e lejeve të subjekteve nga NJVQV<sup>-të</sup> përkatëse të sigurojë në mënyrë të detyruar dhënien e mendimit me shkrim brenda 3(tre) ditëve. Në mungesë të bashkëpunimit të plotë të dhënies së mendimit nga NJVQV<sup>-të</sup> brenda afatit 3 (tre) ditor, DRM Dibër herë pas here për raste e mosdhënies së mendimit të njoftojë zyrtarisht AKM Tiranë dhe Ministrinë e Mjedisit.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi.*

**6. Gjetje nga auditimi:** DRM Dibër për periudhën raportuese 2015; 2016; 2017 deri në 31.07.2018, nuk ka hartuar program pune për bashkëpunim dhe kryerje të kontrolleve të përbashkëta, përveç bashkëpunimit me NJQV (*bashki e njësi administrative*) për mbetje urbane dhe mbetjet spitalore. Ndërmjet DRM dhe ISHMPU Dibër, bashkëpunimi ka qenë në kushtet e pamjaftueshmërisë dhe nuk janë shtrirë kontrollet e monitorimet për informalitetin e zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore në përmbushje të kërkesave të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “*Për mbrojtjen e mjedisit*” dhe kërkesave të përcaktuara në Kreu 5, germa pika (1/n), Kreu VI, germa (a), VKM nr. 47, datë 29.01.2014 “*Për përcaktimin e rregullave për organizimin e funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit*”. (*Trajtuar më hollësisht në faqe xxx të Raportit të Auditimit*).

**6.1. Rekomandimi:** DRM Dibër të marr masa për hartimin e programit vjetor punës, në të cilin të pasqyrohen qartë edhe bashkëpunimi me institucione të tjera, me qëllim kryerjen e monitorimeve nëpërmjet kontrolleve të përbashkëta, në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet DRM Dibër dhe AKM Tiranë me organet e tjera të kontrollit, si me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Dibër dhe ISHMPUT Dibër për informalitetin e zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore dhe ndikimit në mjedis.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi.*

**7. Gjetje nga Auditimi:** DRM Dibër për periudhën raportuese 2015; 2016; 2017 deri në 31.07.2018, ka dhënë **151 mendime për vlerësimin të ndikimit në mjedis (VNM)** dhe për leje mjedisore për licencimet të tipit (A), (B) nga AKM. Për këto DRM Dibër nuk ka informacione nga AKM Tiranë për ecurinë e procedurës për **151 praktika të dhënies të mendimit**. Veprime janë në kundërshtim me urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 1964, datë 13.11.2014 “*Për miratimin e procedurave të administrimit dhe formatit të regjistrave të lejeve të mjedisit të tipit (A), (B) dhe (C)*”. Të dhënat sipas tabelës së lartpërmendur të krahasimit të regjistrit të mendimeve për VNM dhe leje mjedisore tipi (A-B) për periudhën 2015; 2016; 2017 deri në 31.07.2018. (*Trajtuar më hollësisht në faqe xxx të Raportit të Auditimit*).

**7.1.Rekomandim:** DRM Dibër të kërkojë zyrtarisht nga AKM Tiranë, marrjen e të dhënave në lidhje me ecurinë e praktikave të dhënies së mendimeve për VNM<sup>-të</sup> e leje mjedisore tipi (A; B) me synim përditësimin në formë elektronike të regjistrit të lejeve tipi (A,B) sipas formatit standard të miratuar, zbatimin e afateve dhe procedurave ligjore, si dhe mundësimin e bashkëpunimit ligjor me strukturat e tjera si, DRISHMU, NJVQV<sup>-të</sup> dhe QKL.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi.*

**8. Gjetje nga Auditimi:** DRM Dibër në dokumentacionin elektronik të dosjeve për dhënie mendimi për VNM<sup>te</sup> e lejes mjedisore të tipit B (*Hecet*), pothuajse në të gjithë rastet mungojnë praktikatat e procesit të konsultimeve me publikun. Në 34 raste për d gjesat me publikun DRM është shprehur se; “...do të kryhen hap pas hapi në fazën e zbatimit të projektit...”. Nga auditimi u konstatua se, në 43 subjektet që kanë filluar punimet dhe deri në përfundim të periudhës së auditimit, nuk ka informacione për realizimin e tyre, veprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 419, dat 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore të Tipi A,B,C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL”, Kreu I, pika 1/dh, Kreu VI, pika 12; 13; 15; 16 dhe 22. (*Trajtuar më hollësisht në faqe xxx të Raportit të Auditimit*).

**8.1. Rekomandim:** DRM Dibër në bashkëpunim me AKM Tiranë, të marr masa që të plotësojnë praktikatat e dhënies së mendimeve për 43 raste për periudhën 2015 deri në 31.07.2018, si dhe të dërgohen në NJVQV<sup>te</sup> përkatëse regjistri i përditësuar i të dhënave për VNM<sup>te</sup> e lejes mjedisore. Gjithashtu DRM Dibër dhe AKM të bashkëpunojnë dhe të marrin masa për rregullimin e normimit juridik të pikës 6 “Mendimi i DRM pas inspektimit në terren”, të formatit dhënie mendim për VNM dhe LM, me synim bërjen e tij funksional dhe sigurimin e vërtetësisë për përfshirjen e mendimit të NJVQV në VNM dhe në lejet e tipit B.

*Menjëherë dhe në Vazhdimësi.*

**9. Gjetje nga auditimi:** Në studimet për VNM e për leje tip (B) dhe relacionet e paraqitura nga grupet e specialisteve të DRM Dibër, nuk janë përcaktuar sipas projekteve sipërfaqet e zëna me pyllëzime dhe nuk është parashikuar detyrimi i ripyllëzimit të sipërfaqeve të fondit pyjor të ndara sipas zërave kadastral pyje, pyje shkurre, kullota konvertuar në raportet me pikat 1, 2, 5 të urdhrit të Ministrit nr.1937, datë 21.10.2014 “Mbi përcaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore dhe përmirësuar sipërfaqet kullosore që hiqen nga fondi pyjor e kullosor nëpërmjet pyllëzimit, ripyllëzimit dhe përmirësimit të tyre”, pasqyruar në tabelat përkatëse. (*Trajtuar më hollësisht në faqe xxx të Raportit të Auditimit*).

**9.1.Rekomandim:** DRM Dibër dhe AKM Tiranë të marrin masa për rishqyrtimin e verifikimin e dhënies VNM paraprake për 43 (*Hecet*), duke vlerësuar e konsideruar faktorin për identifikimin për të përcaktuar sipërfaqet e zëna sipas emërimit pyje, pyje shkurre, kullota “barishte” të “fondit kullosor” e cila pasi të përcaktohet, të konvertohet në raportin 1 me 2 dhe përcaktohet detyrimi për ripërtëritje të këtij fondi, pasqyruar në tabelën “sipërfaqet dhe zërat kadastral të fondit pyjor kullosor (nxjerrë nga studimet për VNM dhe leje (A, B).

*Menjëherë dhe në vazhdimësi.*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e fondeve të programuara në projekt buxhetet dhe të alokuara për shpenzime të përdorura nga njësia shpenzuese DRM Dibër rezulton se, fondet për shpenzime janë në kushtet e pamjaftueshmërisë për realizimin e funksioneve të institucionit, sepse ka mungesa investimi për pajisje zyre e mjete transporti për lëvizjen e specialistëve për kontroll dhe monitorim të subjekteve që janë pajisur me lejet mjedisore të çdo tipi. Ka mungesa në ambient pune, ku edhe ato në dispozicion janë në kushtet të pa përshtatshme dhe të pa mjaftueshme për punonjësit, njëkohësishtë mungon ambienti për funksionimin e arkivit dhe protokollit. Ka mungesë në fonde për shpenzime operative, për udhëtime të specialistëve jashtë vendit të punës, në territorin e qarkut për ushtrimin e verifikimeve të nevojshme në terren në subjektet e pajisura me leje mjedisore, si dhe për shpenzime për dokumente evidentuese (*larje foto*), të cilat janë të domosdoshme dhe pjesë e procedurave për pasjen me leje mjedisore të tipit (C), apo dhënie mendimi për VNM<sup>te</sup> e leje tipi (A) e (B) të subjektit aplikues. (*Trajtuar më hollësishtë në faqet xxx të Raportit të Auditimit*).

**10.1.Rekomandimi:** DRM Dibër nëpërmjet hartimit të projekt buxhetit, me analizë të plotë të kërkojë pranë Ministrisë së Turizmit e Mjedisit zgjidhjen për të siguruar ambiente të përshtatshme për zyra me qëllim krijimin e kushteve të punës për punonjësit e institucionit, duke përfshirë dhe ambientin për arkiv/protokoll. Njëkohësisht të kërkojë rishikimin alokimit të dhe rritjen fondeve të programuara për shpenzime operative të njësisë shpenzuese DRM Dibër në mbështetje të funksioneve të saj.

*Menjëherë.*

## **B. TË ARDHURA TË MUNGUARA**

**1.Gjetje nga auditimi:** DRM Dibër për 594 raste, subjekte që nuk kanë sjellë vetëmonitorimin, në kundërshtim me neni 29, pika b (ii) të ligjit nr.10488, datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit”, për mos plotësimin e kushteve të lejes dhe plotësimin e numrit të vetëmonitorimeve do të mund të aplikoheshin gjoha deri 300 mijë lekë për cdo rast të paktën në kufiri minimal për vënie gjobe, ku për periudhën 2015-2018 janë krijuar *të ardhurat e munguara për buxhetin e shtetit e përlogaritur në vlerën prej 78,300 mijë lekë* ( $300 \times 261 = 78,3 \text{ milion lekë}$ ). (Trajtuar më hollësisht në faqe xxx të Raportit të Auditimit).

**1.1.Rekomandim:** DRM Dibër në bashkëpunim me ISHMPU Dibër të marrin masa për zbatimin e procedurave ligjore e administrative, për aplikimin e gjobave nga 300 mijë lekë deri 500 mijë lekë, si dhe arkëtimin e vlerës së krijuar nga subjektet të cilët nuk kanë sjellë vetëmonitorimin.

*Brenda muajit dhjetor 2018.*

**2. Gjetje nga auditimi:** DRM Dibër për periudhën 2015-2018 sipas evidentimit nga verifikimi në terren i kryer me inisiativë të DRM<sup>së</sup> është konstatuar se, në teritorin e qarku Dibër ushtrojnë aktivitete të ndryshme biznesi, të cilat duhet të pajisen me leje të tipi (C) janë rreth 700 subjekte. Nga mungesa e bashkëpunimit ndërmjet strukturave, sidomos me ISHMPU konstatohet se, nga mos paisja me leje mjedisore, si dhe nga mos arkëtimi i tarifave për lejet e pa miratuara është krijuar *e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit në shumën 1,400,000 lekë*. (Trajtuar më hollësisht në faqe xxx të Raportit të Auditimit).

**2.1. Rekomandim:** DRM Dibër në bashkëpunim me DRISHMPU Dibër, të vazhdojë ndjekjen e dhe marrjen e masave administartive për dhënien e lejeve tipi (C) dhe arkëtimin e tarifave të aplikimit për leje mjedisi.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi.*

**3. Gjetje nga auditimi:** DRM Dibër për 3 subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesën e tarifës vjetore, por që kanë paraqitur pranë QKB shkresë për pezullim aktiviteti, leje të cilat janë të miratuara për gjatë vitit 2014, para se të miratohej VKM nr. 417, datë 25.06.2014 për shkak të mos pagesës së tarifës vjetore, si pa mjaftueshmëri e ndjekjes nga DRM edhe nga fakti se mungon një rregullshmëri (*udhëzim, urdhër, etj...*) për të ndjekur procedurat në rast pezullim aktiviteti, ndërsa subjektet nuk e sjellin këtë kërkesë edhe në DRM, në mospërputhje me neni 26, pika 1, ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, për pasojë në periudhën 3 vite me tarifë 2,000 lekë/vit nga këto 3 subjekte është krijuar *e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit në shumën 18 mijë lekë*. (Trajtuar më hollësisht në faqe xxx të Raportit të Auditimit).

**3.1. Rekomandim:** DRM Dibër në bashkëpunim me DRISHMP Dibër, të vazhdojë ndjekjen e dhe marrjen e masave administartive për arkëtimin e tarifës vjetore të lejes mjedisore tipi (C), nga 3 subjektet të cilët kanë pezulluar aktivitetin, ndërsa nuk kanë kryer pagesën e tarifës vjetore.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi.*

### **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 57, pika 2; 58 “Ilojet e masave disiplinore” shkronja “ç”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr.115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64, shkronjat “g” dhe “k”, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojë Drejtorit Rajonal të Mjedisit Dibër, që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vrejtje ” për punonjësit si më poshtë:**

F. M. , Nj. V . Sh. S. , A.K , E. K. , M. K

-Për mos përmbushje të detyrës pasi nga komunikimi dhe ballafaqimi rezulton se; kanë kryer veprime në kundërshtim me neni, 26, pika 1, ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “ *Për Lejet e Mjedisit* ” , *Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamentit i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.*

-Në studimet për VNM e për leje tip (B) dhe relacionet e paraqitura nga grupet e specialisteve të DRM Dibër, nuk janë përcaktuar sipas projekteve sipërfaqet e zëna me pyllëzime dhe nuk është parashikuar detyrimi i ripyllëzimit të sipërfaqeve të fondit pyjor të ndara sipas zërave kadastral pyje, pyje shkurre, kullota konvertuar në raportet me pikat 1, 2, 5 të urdhrin të Ministrit nr.1937, datë 21.10.2014 “Mbi përcaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore dhe përmirësuar sipërfaqet kullosore që hiqen nga fondi pyjor e kullosor nëpërmjet pyllëzimit, ripyllëzimit dhe përmirësimit të tyre”, pasqyruar në tabelat përkatëse.

- Nga auditimi u konstatua se, në 43 subjektet që kanë filluar punimet dhe deri në përfundim të periudhës së auditimit, nuk ka informacione për realizimin e tyre, veprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 419, dat 25.06.2014 “*Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisit të Tipi A,B,C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL*”, Kreu I, pika 1/dh, Kreu VI, pika 12; 13; 15; 16 dhe 22.

**1. Xh. D**

**2. V. B.**

**3. V. R.**

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**